



Pranimi / Primesha Received / Delivered	15.03.2022	2 viti god year	
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Pr. No	Shtojca Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSACK	1392/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.62/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Kocanëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, për shqyrtimin e ankesës numër Anr.62/2022 të datës 25.01.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër organit të punësimit Këshilli Prokurorial i Kosovës, në çështjen juridike „kontestim konkursi” dhe duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 10.03.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër Anr.62/2022 e datës 25.01.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me numër KA.nr.01/2022 i datës 19.01.2022 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe **anulohet** procedura rekrutimit për vendin e punës “Zyrtar Administrativ” në Njësitin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë me numër të referencës KPK/SKPK/NJSHPP/POZ-024 si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit ligjor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës, me datën 22.12.2021 ka shpallur konkursin e jashtëm për pozitën: "Zyrtar Administrativ" në Njësitin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi _____ e i cili nuk është përfshirë në listën e ngushtë, për të vazhduar me tutje me fazat e rekrutimit.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 13.01.2022 të Këshillit Prokurorial, për mos përzgjedhjen në listë të ngushtë, me datë 14.01.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe i Ankesave i Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datën 19.01.2022 ka nxjerr Vendimin me numër KA.nr.01/2022, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit _____ dhe ka lënë në fuqi njoftimin e datës 13.01.2022 të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës/Divizioni i Burimeve Njerëzore për kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër KA.nr.01/2022 të datës 19.01.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datën 25.01.2022 nëpërmjet e-mail-it ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimore se i ka plotësuar kushtet e konkursit që të vazhdoj me fazat e më tutjeme në këtë konkurs dhe kërkon nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që ta kthej në pikën zero konkursin për vendin e punës "Zyrtar Administrativ".

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ankesën e ankuesit e ka proceduar tek organi i punësimit/Këshilli Prokurorial i Kosovës, për përgjigje në ankesë me datë 01.02.2022, ndërsa me datë 14.02.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesa e datës 25.01.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursi i datës 22.12.2021; Njoftimi i kandidatëve të përzgjedhur për listë të ngushtë i datës 13.01.2022; Ankesa e ankuesit e datës 14.01.2022 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Aplikacioni për punësim i kandidatit _____ me dokumentacionin e bashkangjitur; Regjistri i aplikacioneve të pranuar si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *është e bazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me mos përfshirjen në listën e shkurtër nga Komisioni Përzgjedhëse i Shërbimit

Civil për pozitën : "Zyrtar Administrativ" në Njësitin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, në Këshilli Prokurorial të Kosovës, gjegjësisht ankuesi ka pretenduar se Komisioni perzgjedhës nuk i ka bërë vlerësimin real të përvojës së punës pasi që i njëjti përvojën e punës e ka dëshmur në bazë të trustit pensional.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se në konkursin e shpallur nga Këshilli Prokurorial i Kosovës të datës 22.12.2021, për pozitën "Zyrtar Administrativ" në Njësitin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë kriteret e konkursit kanë qenë si ne vijim:

- *Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik ose Shkenca Shoqërore,*
- *Një vit përvojë pune.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në dëshmitë e ofruara për përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës të bashkangjitura në dosjen e ankuesit, ka konstatuar se ankuesi posedon Diplomën me numër 7399 të datës 24.11.2016 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin Ekonomik Departamenti Banka, Financa dhe Kontabilitet, ku ka fituar titullin Baçelor per Banka, Financa dhe Kontabilitet, me datë 01.11.2016, po ashtu posedon edhe Diplomën me numër 175/17 të datës 07.09.2017 e lëshuar nga Kolegji Iliria me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet në Programin Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci dhe ka fituar gradën Baçelor i Arteve në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci me datë 14.07.2017, ndërsa sa i përket përvojës së punës posedon Vërtetimin e datës 29.01.2018 të lëshuar nga Zyra e Personelit e Ministrisë së Integritimit Evropian me të cilën dëshmohet se ankuesi

ka kryer praktikën në Ministrinë e Integritimit Evropian përkatësisht në Departamentin e të Drejtës së Bashkimit Evropian nga data 04.09.2017 gjer më 29.01.2018 si dhe Pasqyrën e Trustit Pensional për periudhën 22.01.2014 deri me 22.09.2021 .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha dëshmive për përvojën e punës të bashkëngjitura në dosjen e ankuesit, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, ka dështuar të vlerësoj drejtë dëshmitë e përvojës së punës të ankuesit sepse ankuesi më datë 29.12.2021 e ka dorëzuar aplikacionin për punësim në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës me numër 1604 duke bashkangjitur dëshmitë për përgatitjen profesionale, përvojës së punës dhe certifikatat e trajnimeve konkretisht si dëshmi për përvojën e punës ankuesi ka bashkangjitur Vërtetimin e datës 29.01.2018 të lëshuar nga Zyra e Personelit e Ministrisë së Integritimit Evropian me të cilën dëshmohet se ankuesi

ka kryer praktikën në Ministrinë e Integritimit Evropian nga data 04.09.2017 gjer më 29.01.2018 si dhe Pasqyrën e Trustit Pensional për periudhën 22.01.2014 deri me 22.09.2021 andaj Kolegji duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankuesi e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës pas diplomimit prej një (1) viti ashtu siç është kërkuar në konkurs dhe se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e mospërfshirjes së ankuesi në listën e shkurtë të dates 13.01.2022, ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 nën paragrafin 1.2, dhe nenin 2, 3, 4 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: "Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2. përvojën e punës", 2. Secili anëtar vlerëson kandidatin në se cilin kriter. Numri maksimal i se cilit kriter është 20 pikë.

Numri maksimal është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidatit në procedura te tjera është 40 pikë. 3. Kandidatet të cilët nuk arrijnë numrin minimal të pikëve përjashtohet nga fazat e tjera të përzgjedhjes”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit konkretisht përgjigjen ne ankese të organit të punësimit të datës 14.02.2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, në te cilin ka deklaruar se ankuesi nuk është përzgjedhur ne lisën e shkurte sepse „ nuk ka sjellur asnjë dëshmi që vërteton përvojën e punës ashtu siç kërkohet ne konkurs kontratat e punës po vërtetimet’, ka konstatuar se arsyetimi i organit të punësimit është i paqëndrueshëm sepse në rastin konkret ankuesi ka sjellur dëshmi mbi përvojën e punës „Pasqyrën e Trustit Pensional dhe Vërtetimin e datës 29.01.2018 të lëshuar nga Zyra e Personelit e Ministrisë së Integritimit Evropianë”, mirëpo nëse organi i punësimit respektivisht Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Këshillit Prokurorial të Kosovës ka pasur qëllim që të vërtetojë përvojën profesionale të punës përmes kontratave të punës apo vërtetimeve, atëherë organi i punësimit ka qenë i obliguar ta ftoj ankuesin që të plotësoj dokumentacionin e nevojshëm në pajtim me dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet: „Parimi i informimit dhe ndihmës aktive “1.“Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që mosdija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit. Organi publik, në veçanti, informon palën për të drejtat dhe detyrimet e saj në procedurën administrative, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve të saj gjatë kësaj procedure”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Vendimin me numër KA.Nr.01/2022 të datës 19.01.2022 e ka nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ligjore.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që procedura e rekrutimit për pozitën „Zyrtar Administrativ” në Njësitin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, e shpallur nga Këshilli Prokurorial i Kosovës është zhvilluar në kundërshtim me nenin 11 paragrafit 1 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet që: „Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve” dhe nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: „Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: “Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi

përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: “Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.62/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI,

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqëses së Personelit në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

